



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të dispozitave të nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 Qershor 2008 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, propozon :

Që në pajtim me nenin 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, neneve 6, 15 par.2 dhe 17 të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 21 e datës 13 qershor 2013, Ligjit nr.06/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-179 për transportin rrugor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 15 e datës 11 tetor 2018, Ligjit Nr.08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16 e datës 06 korrik 2023 dhe nenit 20 par. 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2024 të miratoi këtë:

PROPOZIM

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TRANSPORTIN E RREGULLT URBAN PERIFERIK TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS 15Nr.011-7239 E DATËS 31.01.2019

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i miratimit të kësaj Rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i disa dispozitave të Rregullores për transportin e rregullt urban periferik të udhëtarëve me autobus 15nr.011-7239 e datës 31.01.2019.

Neni 2

Plotësimi dhe ndryshimi i dispozitave të Rregullores

1.Me këtë Rregullore ndryshohet dhe plotësohet neni 5, neni 8 paragrafi 1, neni 10 paragrafi 5, neni 11 paragrafi 1, neni 14 paragrafi 1, neni 15 paragrafi 1, neni 16 dhe neni 17 i Rregullores për transportin e rregullt urban periferik të udhëtarëve me autobus 15nr.011-7239 e datës 31.01.2019 dhe riformulohen , si vijon:

AM

Neni 5- Plani i nisjeve dhe caktimi i orareve të rendeve të udhëtimit

1. Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për përmbushjen e nevojave të qytetarëve për transport me autobus, në afat prej dy muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje përgatitë planin e numrit të nisjeve dhe orareve të nisjeve të rendeve të udhëtimit për secilën linjë të përcaktuar me këtë Rregullore.
2. Plani i nisjeve mund të plotësohet në bazë të kërkesave të institucioneve dhe qytetarëve për plotësimin e nevojave për transport.
3. Kërkesat për plotësimin e planit të nisjeve i parashtrohen Drejtoratit të Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim një herë brenda dy viteve nga data e miratimit të tij .
4. Plani i nisjeve dhe orareve të rendeve të udhëtimit nga paragrafët paraparak miratohet me vendim të Kuvendit të Komunës.

Neni 8, paragrafi 1

1. Ndarja e rendeve të udhëtimit sipas orareve të përcaktuara me planin e nisjeve dhe caktimin e orareve të udhëtimit do të bëhet në bazë të shpalljes publike të cilën e shpallë dhe e zbaton Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në pajtim me këtë Rregullore.

Neni 10, paragrafi 5

5. Për transportuesit të cilët i plotësojnë kushtet e aplikimit sipas shpalljes publike, Komisioni harton propozimet konkrete për ndarjen e rendeve të udhëtimit sipas nisjeve të caktuara në kuadër të linjave përkatëse dhe ia dërgon për miratim dhe marrje të vendimit Drejtorit të Drejtoratit për Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 11, paragrafi 1

1. Në propozim të Komisionit, Drejtori i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim merr Vendim me të cilin operatorit të caktuar i ndahen rendet e udhëtimit sipas nisjeve të caktuara në kuadër të linjave përkatëse.

Neni 14, paragrafi 1

1. Transportuesit i revokohet rendi i udhëtimit nga Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në bazë të raporteve të inspektorit komunal të transportit rrugor për rastet kur transportuesi:

Neni 15, paragrafi 1

1. Vendimet për revokimin e rendeve të udhëtimit i nxjerr Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për rastet e përcaktuara në nenin paraparak në bazë të raporteve të inspektorit komunal të transportit rrugor.

16 – Procedura për ndarjen e rendeve të revokuara të udhëtimit

Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në bazë të vendimeve të plotfuqishme mbi revokimin e rendeve të udhëtimit, do të bëjë ndarjen e rendeve të revokuara të udhëtimit sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje të parapara në Kapitullin IV - të - Ndarja e orareve të rendeve të udhëtimit.

Neni 17- Obligimet e organeve komunale

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Inspeksion – Inspektorët komunal të transportit rrugor.

Neni 3 Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pune pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Baza Ligjore për miratimin e kësaj Propozim- Rregulloreje është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, neneve 6, 15 par.2 dhe 17 të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 21 e datës 13 qershor 2013, Ligjit nr.06/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-179 për transportin rrugor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 15 e datës 11 tetor 2018, dhe nenit 20 par. 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Me këtë Projekt- Rregullore ndryshohet dhe plotësohet neni 5, neni 8 paragrafi 1, neni 10 paragrafi 5, neni 11 paragrafi 1, neni 14 paragrafi 1, neni 15 paragrafi 1, neni 16 dhe neni 17 i Rregullores për transportin e rregullt urban periferik të udhëtarëve me autobus 15nr.011-7239 e datës 31.01.2019.

Te neni 5 ndryshohet e gjithë përmbajtja e nenit ashtu që i bartet kompetenca për miratimin e Planit të nisjeve dhe orareve të rendeve të udhëtimit Kuvendit të Komunës pasi që deri me tani me dispozita të Rregullores për transportin e rregullt urban periferik të udhëtarëve me autobus 15nr.011-7239 e datës 31.01.2019 ka qenë e paraparë që Plani i nisjeve dhe orareve të rendeve të udhëtimit të miratohet me Vendim të Kryetarit të Komunës pasi që me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor nuk ka qenë e qartësuar se a duhet të miratohet nga Kryetari i Komunës apo nga Kuvendi i Komunës ndërsa te nenet tjera 8,10,11, 14,15, 16 dhe 17 ndryshimi ka ndodhur vetëm te emërtimi i Drejtoratit nga Drejtorati për Shërbime Publike në Drejtoratin për Shërbime, Publike Mbrojtje dhe Shpëtim me qëllim të harmonizimit me dispozitat e Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, në bazë të cilt ka ndryshuar emërtimi i drejtoratit që ka rezultuar edhe me shtimin e përgjegjesive të punës së Drejtoratit Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e kësaj Propozim Rregulloreje.

1Nr. 345/01-33179
Lipjan, më 11.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

